



Kushte komode, seriozitet dhe shume entuziazem. Ne grumbullimin e perfaqesues kuqezi, gjen nga te gjitha ato qe deshiron. Stafi punon me seriozitet, lojtaret kane entuziazmin e duhur para ndeshjes me Slloveni dhe kushtet jane te mrekullueshme. FSHF ka beret e mundur gjetjen e nje kampingu te perhershëm ne Durres, ne nje kompleks privat, aty ku ka fusha per stervitje dhe kushte mjaft te mira. Lojtaret ndihen komod, stafi me ne krye De Biazin gjithashtu dhe tani te gjithë shpresojne tek nje kualifikim i mundshëm ne Brazil, enderr e cila i perndjek te gjithë shqiptaret prej disa muajsh. Prej 2 shtatorit kuqezinjte jane grumbulluar dhe po sterviten ne Durres ku do te qendrojne deri ne daten 5 shtator.